

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit D.L., për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.5 lidhur me par.1 të KPRK, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.F.K., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.248/16, të dt.23.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPRK, me dt.27.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZHET e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.248/16, i dt.23.11.2016 VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.248/16, të dt.23.11.2016, i akuzuari D.L., është shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.5 lidhur me par.1 të KPRK, për të cilën vepër penale i është përcaktuar dënim ime burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, për të cilën vepër penale i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë)muaj dhe për

veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK, për të cilën veprën penale i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)muaj dhe për këto vepra është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 6(gjashtë)muaj, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.23.12.2015, e në vazhdim.

Ndaj të akuzuarit është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të marr formën e prerë, por jo më gjatë sesa dënimi i shqiptuar me aktgjykim.

Nga i akuzuari është konfiskuar arma automatike AK-47, kal.7.62mm, me numër serik 101006.

I akuzuari është detyrua që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50Euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit, av.F.K., për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim shumë më i butë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.46/17, të dt.31.01.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit në të cilën ishin prezent i dëmtuari B.M., përfaqësuesja e viktimave H.H., i akuzuari D.L., mbrojtësi i të akuzuarit av.F.K., ndërsa në seancë nuk prezantoi prokurori i shtetit dhe i dëmtuari I.I., për të cilët pati prova se janë njoftuar me rregull për seancën e kolegjit, prandaj gjykata nuk pati pengesa ligjore që të mbaj të njëjtën.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.F.K., sqaroi pretendimet ankimore dhe propozoi si në ankesë.

I akuzuari D.L., deklaroi se përkrah fjalët e mbrojtësit të tij.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata duke shqyrtuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 par.1 të KPPK, gjeti se aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka qenë prezent, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka pasur mbrojtës dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.F.K., pretendon se vendimi mbi dënim është marrë duke u bazuar vetëm në rrethanat lehtësues, duke mos gjetur rrethana rënduese, por edhe pse janë përmendur rrethanat lehtësuese mbrojtja konsideron se gjykata nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë, këto rrethana lehtësuese po të vlerësoheshin në mënyrë të drejtë dhe të merreshin në konsideratë më shumë, vendimi mbi dënim do të ishte më i butë dhe rrethanat në fjalë do të reflektonin që gjykata të pandehurit ti shqiptoj një dënim në proporcion me të gjitha rrethanat lehtësuese, i cili dukshëm do të ishte më i butë e jo kaq i ashpër si i është shqiptuar të pandehurit.

Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar sa duhet rrethanën lehtësuese sidomos rrethanën posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i pandehuri, moshën e tij të re, gjendjen shpirtërore dhe emocionale të cilën e ka përjetuar i pandehurit me kryerjen e kësaj vepre penale dhe këtë e ka shpreh në të gjitha fazat e procedurës, i pandehuri është student dhe vendimi kaq i ashpër do të ndikoj negativisht në rrjedhën e jetës së tij dhe zhvillimore në aspektin e studimeve, dorëzimin vullnetar të të pandehurit te organet, mos dashja e shkaktimit të pasojës nga ana e të akuzuarit, pajtimi në mes të familjeve, të gjitha këto rrethana është dashur që dukshëm të ndikojnë në vendimin mbi dënim, prandaj, mbrojtja konsideron se dënimi i shqiptuar është i ashpër.

Pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të dënimit, ka pasur parasysh rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, kështu si rrethana lehtësues gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka marrë parasysh rrethanat se i akuzuari ka pasur sjellje të mirë para dhe pas kryerjes së veprës penale, se më parë nuk ka kryer vepra tjera penale, se i njëjti ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, se ka moshën relativisht të re, është në vijim të studimeve, ka arritur një marrëveshje-pajtim familjar me të dëmtuarit, si dhe faktin se që në fillimin e shqyrtimit gjyqësor në tërësi ka pranuar fajësinë dhe ka shfaqur pendim të thellë për veprën penale të kryer, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur, e me aplikimin e institutit për zbutjen e dënimit, të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin që u theksua më lartë.

Rrethanat lehtësuese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e përcaktimit të dënimit i aprovon edhe kjo gjykatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson asnjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë, nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë. Theksimet e mbrojtësit të akuzuarit në ankesë se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se është i moshës së re, se është student, pajtimin në mes të familjes së të akuzuarit dhe tani të ndjerit, janë rrethana të cilat realisht dhe drejt janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, meqenëse mbrojtësja e të akuzuarit në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, atëherë kjo gjykatë gjen se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, është i pabazuar.

Në rastin konkret nga veprimet e të akuzuarit D.L., ka humbur jetën Y.M., i moshës 11 vjeçare, i cili me asnjë veprim nuk ka kontribuar në këtë ngjarje, prandaj, sipas gjetjes së kësaj gjykate dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është i ashpër si pa të drejtë pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, por edhe sipas kësaj gjykate dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se vetëm me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 41 të KPRK e që është që të parandaloj të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.34/2017, të datës 27.02.2017

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Anëtares e kolegjit:

1.Vahid Halili

2.Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Fillim Skoro
